

*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 17.01.2025*

17.01.2025
Ora, 13:47

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 5, datë 20.11.2020 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, i ndryshuar”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- **Ilijana NANO Kryetar**
- **Arens ÇELA Anëtar**
- **Dritan ÇAKA Anëtar**
- **Helga VUKAJ Anëtar**
- **Muharrem ÇAKAJ Anëtar**
- **Stafi KQZ E. Meta, A. Nasto.**

Parti Politike: PD (F. Nuri), PS (E. Xhina)

OJQ: KRIIK

Znj. I. Nano: Përshëndetje! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme. Në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator, zyrtarë të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, përfaqësues të partive politike dhe përfaqësues të shoqërisë civile, përkatësisht të organizatës KRIIK. Në rendin e ditës së mbledhjes së sotme kemi një projektvendim, atë “Për disa shtesa

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 17.01.2025*

dhe ndryshime në vendimin nr. 5, datë 20.11.2020 të Komisionit Rregullator “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Zonës së Administrimit Zgjedhor”, i ndryshuar”. Paraprakisht, për procedurë do të pyes së pari kolegët, anëtarë të Rregullatorit dhe më tej përfaqësuesit e partive politike, nëse kanë çështje jashtë rendit të ditës për të diskutuar. Kolegë, nuk ka! Nga ana juaj? Zoti Nuri? Keni një...

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Një çështje jashtë rendit të ditës? Po!

Znj. I. Nano: Dakord! Do të mbarojmë me shqyrtimin e projektvendimit dhe pastaj do të merrni fjalën për çështje jashtë rendit të ditës. Zonja Xhina, ju?

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Jo!

Znj. I. Nano: Faleminderit! Fillojmë me shqyrtimin e projektvendimit që kemi në rendin e ditës, është propozim i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Zoti Meta, një përmbledhje të shkurtër, meqenëse është një akt ndryshues.

Z. E. Meta: Përshëndetje të nderuar! Komisioni Rregullator ka miratuar Vendimin nr. 05, datë 20.11.2020, “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e KZAZ-së”. Qëllimi i këtij vendimi është të përcaktojë rregullat për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të KZAZ-së. Qëllimi i projektvendimit të propozuar për miratim para jush, është përmirësimi dhe përditësimi i dispozitave dhe rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor duke përfshirë mekanizma më të qartë për procesin e depozitimit të dokumentave. Vetëdeklarimet e kandidatëve dhe procedurat për

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 17.01.2025*

dorëzimin e detyrave si dhe për të adresuar problematikat e hasura në zgjedhjet përendëse. Përgjatë procesit të rekrutimit të anëtarëve të KZAZ-ve në zgjedhjet e datës 14 maj 2023, u konstatuan këto problematika:

- Propozimi i kandidaturave nga ana e subjekteve është bërë pa pëlqimin e kandidatit që rezultoi në dorëheqje masive.
- Propozimi i disa anëtarëve të KZAZ-ve në listat shumëëmërore të subjekteve zgjedhore për kandidatë të këshillave apo në marrëdhënie pune me kandidatët. Ka rezultuar se 40% e administratës zgjedhore e nivelit të dytë, pra e KZAZ-së, ka pësuar ndryshime përgjatë gjithë periudhës së funksionimit të tyre duke prekur 96% të KZAZ-ve. Pra, 88 nga 92 KZAZ. Në katër raste Komisioneri ka marrë vendim për shkarkimin e katër anëtarëve të KZAZ-ve. Propozimet e paraqitura për miratim në këtë projektvendim synojnë të adresojnë këto problematika si dhe përmirësimin e mënyrës së komunikimit ndërmjet partive politike me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Projektvendimi ju është dërguar partive politike dhe organizatave të shoqërisë civile. Organizata KRIIK ka kërkuar që në projektvendim për kandidatët të cilët janë nëpunës të administratës publike të dorëzohet kërkesa edhe leja, apo dokument i njëvlerëshëm nga punëdhënësi për të dëshmuar në këtë mënyrë, edhe ligjshmërinë e procedurave të ndjekura nga nëpunësi dhe administrata publike. Ky rekomandim është marrë në konsideratë nga administrata e KQZ-së dhe është reflektuar në projektvendimin e paraqitur për miratim. Ndryshimet dhe shtesat e propozuara synojnë të adresojnë sfidat aktuale në zbatimin e rregullores në fuqi dhe të forcojnë qartësinë dhe transparencën e procedurave, të garantojnë administrim zgjedhor efikas dhe të besueshëm. Bashkëlidhur projektvendimi për shqyrtim dhe miratim.

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 17.01.2025*

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Meta! Fillojmë me shqyrtimin dhe diskutimin në parim të projektaktit! Kolegë kush ka diçka në parim për projektaktin? Nuk ka! Përfaqësuesit e partive politike dhe të shoqërisë civile në parim? Nuk ka! Kalojmë në votimin në parim të projektvendimit. Kolegë,

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Fillojmë shqyrtimin nen për nen.

Me propozimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, Komisioni Rregullator, vendosi:

I. Në tekstin e Vendimin nr. 05, datë 20.11.2020, "Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e KZAZ-së", i ndryshuar, të Komisionit Rregullator, bëhen ndryshimet dhe shtesat si më poshtë vijon: Do t'i lexoj pika një nga një dhe pastaj do t'i votojmë.

1. Në nenin 6, në fund të pikës 2, shtohet fjalia me këtë përmbajtje: "Në çdo rast lista paraqitet dhe/ose në platformën elektronike të dedikuar nga personi përgjegjës i autorizuar nga KQZ me kredencialet përkatëse në këtë sistem.". Besoj se kolegët e kanë parë pikën ku ndryshohet. Pra, në nenin 6, pika 2 kemi këtë shtesë. Ndonjë diskutim për këtë pikë? Kalojmë në votimin e pikës 1, pra ndryshimin e nenit 6, në fund të pikës 2 shtohet fjalia që sapo lexuam.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 17.01.2025*

Pika 2, e projektvendimit. Në nenin 6, pika 5, pas germës b), shtohen germat c) dhe ç), me këtë përmbajtje:

- Vetëdeklarimin e kandidatit se plotëson kushtet e përcaktuara ne nenin 31 të Kodit zgjedhor dhe se nuk është në kushtet e papajtueshmërisë sipas përcaktimeve të nenit 30 të Kodit Zgjedhor.

- Për kandidatët që janë nëpunës të administratës publike dorëzohet kërkesa dhe leja e dhënë nga punëdhënësi për t'u angazhuar si anëtar i administratës zgjedhore apo një dokument i njëvlershëm;

Për këtë pikën e dytë, unë kam një propozim të vogël. Ajo çfarë ne na intereson është leja nga punëdhënësi si dhe në përputhje me ligjin për rregullat e etikës, jo kërkesa. Kërkesa është pjesë e një procedure të brendshme të zyrtarit me institucionin ku është i punësuar. Në zbatim qoftë të ligjit “Për rregullat e etikës”, 9131/2003, qoftë të VKM nr. 274 “Për zbatimin e rregullave të etikës”, mendoj se leja është e domosdoshme. Në këtë pikë, unë propozoj të hiqet fjala “kërkesa”. Kemi propozime të tjera?

Kalojmë në votimin e këtij propozimi, pra të votohet teksti duke hequr fjalën “kërkesa”?

Kush është dakord kolegë?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Pika 3. Në nenin 11 germa “ë” ndryshohet si më poshtë vijon:

“Në rast se anëtari/ sekretari i KZAZ-së ose subjektet zgjedhore evidentojnë ose dyshojnë se një anëtar ose sekretar i KZAZ-së është në një nga kushtet e papajtueshmërisë të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni duhet të informojë menjëherë Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve me një raport të argumentuar, të

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 17.01.2025*

shoqëruar me faktet dhe dokumentacionin që provon ekzistencën e kushteve të parashikuara në këtë paragraf.” Diskutime? Ndoshta vetëm harmonizimi pikë-paragraf, nuk është për të bërë propozim, gjatë zbardhjes, ju lutem! Po zonja Xhina, keni diçka?

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Jo, në fakt do kisha pak për fjalën “dyshoj”, me thënë të drejtën se ndoshta do të lihet vend për subjektivizëm dhe ndoshta mund të zëvendësohet nga togfjalëshi “kanë të dhëna që ngrenë dyshime”. Normalisht nuk mund të bazohet vetëm te dyshimet e një individi rastin. Nëse do të formulonim fjalinë “kanë të dhëna se ngrenë dyshime se një anëtar, ose sekretar është në një nga kushtet...”, ndoshta do të bënte më të bazuar faktin. Si ta vlerësoni ju, por thjesht për të shmangur subjektivizmat.

Znj. I. Nano: Këtu është “evidentojnë, ose dyshojnë”. Edhe evidentimi nënkupton evidencë.

Z. M. Çakaj: Në fakt, nëse kalojmë te formulimi që ju propozuat “kanë të dhëna”, unë besoj se e zgjerojmë shumë dhe marrin tagra. Pastaj duhet t’i hyjnë një hetimi administrativ se çfarë konsiderohet të dhëna, ose jo dhe potencialisht mund të krijojë debat midis KZAZ-së. Ndërkohë që qëllimi nuk është ky. Qëllimi është që kushdo që evidenton, apo ka dyshime, të sinjalizojë KQZ-në, Komisionerin Shtetëror të Zgjedhjeve. Këtë e shqyrton niveli i parë i administrimit të zgjedhjeve që është KQZ-ja. Unë e gjej korrekte këtë formulim nga ana e administratës.

Znj. I. Nano: Atëhere, votojmë tekstin sikundër është paraqitur? S’kemi të tjera ndërhyrje.

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 17.01.2025*

Kush është dakord kolegë?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Pika 4. Në nenin 11, shtohet pika 2 me këtë përmbajtje:

“Administrata e KQZ heton administrativisht pretendimet e palëve dhe shqyrton dokumentacionin e paraqitur duke përfshirë konsultimin apo komunikimet në rrugë elektronike me palët dhe përgatit një raport të detajuar me gjetjet dhe rekomandimet e tij.”. Kemi diçka për këtë nen? Kalojmë në votim!

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Pika 5. Në nenin 12, shtohet pika 5, me këtë përmbajtje:..., edhe këtu kujdes gjatë zbardhjes, themi shtohet pika 5 është vendosur “a”, gjithsesi në zbardhje kur ta unifikoni aktin e vlerësoni. “Anëtari/sekretari merr në dorëzim detyrën duke plotësuar një procesverbal në të cilin përmbledhen dokumentet e administruara, plotësuara dhe të gjitha materialet e dorëzuara me anëtarin/sekretarin që largohet. Një kopje e procesverbalit i dorëzohet menjëherë KQZ-së dhe një kopje administrohet nga Sekretari i KZAZ-së.”. Kolegë, ndonjë ndërhyrje? Jo! Kalojmë në votim!

Kush është dakord kolegë?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Pika 6. Në nenin 16 pika 3, pas togfjalëshit... të lutem edhe një herë zoti Meta!

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 17.01.2025*

Z. E. Meta: Pas togfjalëshit telefonike...

Znj. I. Nano: Pas fjalës “telefonike” hiqet togfjalëshi

Z. E. Meta: “të rrjetit fiks”.

Znj. I. Nano: Dakord! Pra, kemi telefonike dhe heqim të rrjetit fiks, dakord! Edhe njëherë, “Në nenin 16 pika 3, pas fjalës “telefonike”, hiqet togfjalëshi “të rrjetit fiks”. Kolegë?

Kush është dakord kolegë?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka!

Miratohet me 5 vota pro!

- Në nenin 26, pika 3 dhe 4 ndryshojnë si më poshtë vijon:

“3. Anëtari dhe sekretari i KZAZ-së, brenda 5 ditëve pas publikimit të listës së kandidatëve për deputetë/organeve drejtuese të njësive të vetëqeverisjes vendore, duhet të vetëdeklarojë nëse është ose jo në marrëdhënie krushqie, gjinie apo marrëdhënie pune me ndonjë prej kandidatëve sipas përcaktimeve të nenit 32, pika 2 të Kodit Zgjedhor. Në çdo rast, nëse anëtari i KZAZ-së emërohet pas kësaj periudhe, duhet të dorëzojë në KQZ edhe formularin e vetëdeklarimit të konfliktit të interesit sipas modelit të miratuar nga Komisioneri”. Pika e rradhës, ndryshime në nenin 26 janë të dyja këto.

“Pika 4. Sekretari i KZAZ-së dërgon në KQZ, jo më vonë se 2 ditë pas afatit të përcaktuar në pikën 3 të këtij neni, vetëdeklarimet e anëtarëve/sekretarit të KZAZ-së. Në rastet kur anëtari ka deklaruar se është në kushtet e konfliktit të interesit, KQZ-ja i kërkon subjektit politik propozues të sjellë një propozim tjetër për

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 17.01.2025*

zëvendësimin e anëtarit në fjalë brenda 3 ditëve”. Kolegë, kemi diçka për këto pika?
Jo! Kalojmë në votim?

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka!

Miratohet me 5 vota pro, pika 7 e projektvendimit!

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka!

Miratohet me 5 vota pro!

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor... po zoti Çakaj!

Z. M. Çakaj: Këtu të shtojmë dhe organin që ngarkohet, që në rastin konkret është KQZ-ja, për zbatimin e këtij vendimi.

Znj. I. Nano: Besoj se është në aktin bazë, por vetëm një moment, nëse bëjmë një kontroll të shpejtë nëse akti bazë e ka, nëse jo e shtojmë këtu.

Z. M. Çakaj: E ka, e ka!

Znj. I. Nano: Dakord! 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e tij.

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 17.01.2025*

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s'ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Kalojmë në votimin në tërësi të projektvendimit...

Z. M. Çakaj: Atëhere, akti bazë udhëzimi nr. 5/2020 mbaron me nenin 33, Hyrja në fuqi “Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Faqen Zyrtare të KQZ-së”. Pra, nuk kemi përcaktuar organet që ngarkohen, institucionet, ose organet, apo palët e treta që ngarkohen me zbatimin e këtij akti. Në rastin konkret janë, së pari Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, së dyti partitë politike të cilët propozojnë anëtarët, sekretarët e nivelit të dytë zgjedhor, KZAZ-ve.

Znj. I. Nano: Mendoj se duhet t’ia ngarkojmë administratës së Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Për ta akomoduar këtë gjë, mendoj që duhet ta bëjmë ndryshimin te neni 33.

Z. M. Çakaj: Dakord, po ka një moment që në Kodin Zgjedhor parashikohet që partitë politike janë të detyruara të propozojnë, qoftë kryesisht qoftë edhe në momentin që kërkojnë të zëvendësojnë anëtarët, kështu që kanë dhe ato një rol aty. Vetëm në rast se ato dështojnë të propozojnë, ose nuk paraqesin brenda afatit. Atëherë, i ngarkohet Komisionit Qendror të Zgjedhjeve që të plotësojnë vakancat. Gjithësesi të hapur jemi për këtë.

Znj. I. Nano: Atëherë, ku mendoni ta akomodojmë te neni 33? Pra, të bëjmë një shtesë te akti bazë. Pra, do të jetë ndërhyrja te neni 33 cili do të ketë dy fjali. Fjalja

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 17.01.2025*

e parë, “Ngarkohet administrata e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve me zbatimin e këtij vendimi”. Fjalinë e dytë e lemë siç ishte.

Z. E. Meta: Pra, do të shtohet pika 3, para se ky vendim të hyjë në fuqi, me formulimin...

Znj. I. Nano: Pika 8 e vendimit. Neni 33 riformulohet si më poshtë:

Ngarkohet me zbatimin e këtij vendimi administrata.., Komisioni Qendror i Zgjedhjeve”. Fjalja e dytë mbetet siç ka qenë dhe pastaj kalojmë në pikat 2 dhe 3 të këtij projektvendimit të sotëm. Atëherë, votojmë ndryshimin në nenin 33, kolegë.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Pikën 2 dhe 3 të projektvendimit të sotëm i miratuam. Kalojmë në votimin në tërësi, kolegë?

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj. I. Nano, z. A. Çela, z. D. Çaka, znj. H. Vukaj, z. M. Çakaj)

Kundër: s’ka!

Miratohet me 5 vota pro!

Vendimi nr. 2

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 17.01.2025*

17.01.2025
Ora, 13:47

JASHTË RENDIT TË DITËS

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- | | | |
|------------|-------|--------------------|
| • Ilirjana | NANO | Kryetar |
| • Arens | ÇELA | Anëtar |
| • Dritan | ÇAKA | Anëtar |
| • Helga | VUKAJ | Anëtar |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar |
| • Stafi | KQZ | E. Meta, A. Nasto. |

Parti Politike: PD (F. Nuri), PS (E. Xhina)

OJQ: KRIIK

Znj. I. Nano: Çështje të tjera në rendin e ditës ne nuk kemi, kërkoi zoti Nuri fjalën për një çështje jashtë rendit të ditës. Zoti Nuri!

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Faleminderit për fjalën! Unë sot dua të mbaj një qëndrim politik në lidhje me mohimin e fjalës që na u bë gjatë mbledhjes së shkuar, nga ju zonja Kryetare! E konsiderojmë një ndërhyrje që nuk ka ndodhur dhe e paprecedentë, sepse ne jemi përfaqësues të partive politike. Unë jam përfaqësues i Partisë Demokratike, përfaqësues i përhershëm në KQZ. Kjo gjë nuk ka ndodhur asnjëherë më parë, as në KAS, as nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, që t'i mohohet fjala përfaqësuesve të partive politike. Ne ishim prezentë në mbledhje nga

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 17.01.2025*

fillimi në fund, nuk patëm objeksion në aspektin teknik. Patjetër që ishim prezentë për të bërë dhe për të kërkuar disa sqarime jashtë rendit të ditës drejtuar KQZ-së dhe administratës, konkretisht Drejtorisë së Votimit nga Jashtë për çështjen e votimit të emigrantëve, për regjistrimin e diasporës. Ato qëndrime që nuk mund t'i mbanim atë ditë, do t'i mbaj sot, sepse në atë mbledhje u thanë disa të pavërteta të mëdha. Konkretisht u tha që “nuk kishte denoncime të ardhura nga subjekte, apo nga organizata të tjera”. Ndërkohë që ka pasur me dhjetra dhe ka me dhjetra denoncime të ardhura, qoftë dhe nga OJF të ndryshme që monitorojnë zgjedhjet, si Qëndresa Qytetare, për sa i takon shkeljeve të Kodit Zgjedhor lidhur me veprimtaritë e ndaluara katër muaj para datës së zgjedhjeve. Ne si subjekt politik dhe në media po ashtu janë pasqyruar pa fund denoncime dhe raste ku janë abuzuar dhe po abuzohet për ditë nga administrata shtetërore, nga zyrtarë të lartë të shtetit që po shkojnë në diasporë dhe po keqpërdorin funksionet e tyre për qëllime zgjedhore dhe elektorale. Konkretisht ka ministra, zyrtarë të lartë, të cilët lënë takime në kuadrin e tyre si ministra të shtetit për takime në diasporë, Itali, Greqi, Angli e me rradhë, ndërkohë që nuk kanë fare as këtë rol për të zbatuar, në këtë moment që jemi edhe jashtë fushatës elektorale zyrtare. Nga ana tjetër, jemi në dijeni të fakteve që ka zyra elektorale përballë ambasadave, përballë konsullatave shqiptare dhe kjo është e papranueshme. Për më tepër ajo që është edhe më e papranueshme, që ka staf diplomatik. Kemi informacione që na kanë ardhur të shumta. Ka staf diplomatik nga niveli më i ulët deri në nivelet më të larta të ambasadave dhe konsullatave tona jashtë vendit që po keqpërdorin detyrat e tyre funksionale dhe janë duke u marrë me fushatë zgjedhore. Janë duke u marrë me regjistrimet e emigrantëve në diasporë dhe për të gjitha këto shqetësime ne nuk e kuptuam pse nuk u dha fjala në mënyrë që opozita të kërkonte të denonconte në rradhë të parë këto fenomene. Të kërkonte nga KQZ-ja dhe prandaj jemi këtu që ta kërkojmë dhe një herë, ta ripërsërisim. Kërkojmë një

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 17.01.2025*

qëndrim zyrtar të prerë, një deklaratë nga KQZ-ja që të bëhet thirrje dhe të shmanget keqpërdorimi i burimeve, aseteve funksioneve publike nga shteti që janë në kundërshtim me rregullat e KQZ-së 4 muaj para zgjedhjeve të gjitha këto veprimtari të ndaluara nuk duhet të tolerohen. Kemi raste të denoncuara. Po ju sjellim një shembull tjetër, nga zyrat vendore të arsimit, ku shkollat gjimnazet e me rradhë vazhdojnë avazin dhe publikojnë dhe shpërndajnë në facebook e rrjete të tjera sociale, veprimtari politike që nuk kanë lidhje fare me veprimtarinë e tyre si insitucione arsimore. Të gjitha këto janë të patolerueshme. Ne kërkojmë që KQZ-ja të bëjë thirrje që të zbatohet ligji ashtu siç është. Nga ana tjetër kërkojmë një transparencë nga ana e administratës së KQZ-së, në lidhje me regjistrimin e votës së diasporës. Si po ecin procedurat, pengesat dhe ato shqetësime që kemi dashur t'i shprehim herën e fundit? Do të donim që të kishim një sqarim në lidhje me ecurinë e këtij procesi deri tani edhe me thjeshtëzimin e procedurave. E theksojmë me thjeshtimin e procedurave, që ne i kemi kërkuar dhe ju i keni miratuar si rregullator që procedurat duhet të ishin të thjeshta. Por sikundër dhe vetë Komisioneri e shprehu dje në një emision televiziv me audiencë të gjerë, vetëm 50% e aplikimeve kanë dalë me sukses në tentativën e parë. Kjo tregon që nuk paska qenë kaq e thjeshtë dhe nuk qenka kaq i thjeshtë ky proces regjistrimi. Për ta përmbyllur ne kërkojmë një deklaratë të fortë nga ana e KQZ-së si insitucion në lidhje me të gjitha këto shqetësime që kemi ngritur.

Znj. I. Nano: Zoti Nuri faleminderit! Lidhur me qëndrimin në mbledhjen e kaluar më lejoni të them teknikisht diçka. Nuk ua dhashë fjalën as ju dhe as zonjës Xhina, nisur nga fakti që nuk kishit kërkuar për çështje jashtë rendit të ditës fjalën. Megjithatë në çdo rast meqë jemi pranë zgjedhjeve dhe padyshim partitë politike sot dhe nesër subjektet zgjedhore kur të marrin këtë status do ta kërkojnë fjalën, janë të

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 17.01.2025*

mirëpritur. Qoftë jashtë rendit të ditës, qoftë brenda rendit të ditës, qoftë në fillim qoftë në fund. Vetëm për të disiplinuar pak rradhën e folësve. Asnjë qëndrim tjetër prej më shumë se katër vitesh në këtë Komision. Keni ju zonja Xhina atëherë diçka? Se do më akuzoni dhe ju që nuk ju dhashë fjalën. Të paktën jeni vetëm dy sot se do të kemi dhe shumë të tjerë në mbledhjet e ardhshme.

Z. M. Çakaj: Më fal në të dyja rastet kemi shkelje të rregullores. Zonja Xhina rradhën e parë e kërkoi fjalën nuk ua dhatë. Kësaj rradhe e kërkoi paraprakisht për çështje jashtë rendit të ditës vetëm zoti Nuri, ja dhatë. Për respekt të rregullores tonë do të duhet siç vepruat herën e parë do të duhet të mbani një standard. Megjithatë nuk ka problem. Ky është një institucion i hapur, transparent mund të flasë kushdo. Unë jam dakord!

Znj. I. Nano: Unë ja thashë zotit Nuri. Megjithatë thashë, pavarësisht qëndrimit në mbledhjen e kaluar jeni këtu, do të jeni edhe më shumë, se sot janë vetëm dy. Kështu që, kur të duan le ta marrin fjalën, vetëm të respektojmë rradhën dhe të mos ndërpresim njëri tjetrin.

Z. M. Çakaj: Shumë dakord! Uroj të mbahet ky standard nga tani e në vijim.

Znj. I. Nano: Jeni 4 guardianë të tjerë këtu, që të më thoni nëse po shkel apo po zbatoj mirë rregulloren. I mirëpres të gjitha sugjerimet! Faleminderit! Zonja Xhina!

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Faleminderit! Unë nuk e di në fakt pse u frikësuat nga fjala ime, por di që pavarësisht faktit që nuk e kërkova fjalën për jashtë rendit të ditës, kam të drejtë që në momentin që bëhet një diskutim politik të marr patjetër

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 17.01.2025*

pjesë në këtë diskutim politik. Nuk është çështja e rendit të ditës sa i takon këtij diskutimi ligjor dhe unë nuk e ngrita. Për sa kohë bëhet diskutim politik palët janë të hapura se ne jemi përfaqësues të partive politike. Gjithësesi të them të drejtën nuk do të zgjidhja që të bëja diskutime politike në këtë panel, por për sa kohë që shtrohen jam e detyruar që edhe unë t'i bashkohem debatit politik. Dimë që herën e shkuar këtu u hap një diskutim politik dhe u pyet nëse ka denoncime që lidhen me palë të ndryshme që mund t'i kenë depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe e morëm përgjigjen që nuk kishte denoncime. Nga ana tjetër nëse përmendet fakti i ambasadave, nuk di zyrave që janë hapur, nuk di raste të dokumentuara që të na jenë servirur dhe ne të mund të shprehemi mbi to. Por unë mund të paraqes një rast që është i dokumentuar, i publikuar në website të ndryshme dhe ku thuhet dega e PD-së në Bedford, Angli jep ndihmë për regjistrimin në portalin e KQZ-së për të votuar në 11 Maj. Mbulojmë zonat Pluton, Cambridge etj etj, çdo të shtunë e të dielë ora 16:00-19:00. Si mund t'i përgjigjemi këtij njoftimi që ka dalë nëpër rrjetet sociale e kudo, që ndihmohen qytetarët, thirren që të shkojnë të aplikojnë e të regjistrohen. Pra, si mund t'i përgjigjemi këtyre rasteve. Gjithsesi...

Z. M. Çakaj: Ja një sekondë meqë e doni në formë debati!

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Ju nuk jeni përfaqësues politik! Ta mbaroj, të lutem!

Z. M. Çakaj: Në mbështetje të kërkesës tuaj...

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 17.01.2025*

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Unë nuk po bëj kërkesë. Unë po bëj diskutim. Nuk zgjedh t'i bëj këtu kërkesat. Ka portale ku denoncohet, ka vend ku depozitohen kërkesat. Nuk zgjedh asnjëherë t'i bëj këtu denoncimet!

Z. M. Çakaj: E para, e nderuar! Këtu nuk jemi në sallë parlamenti! Debatimi politik zhvillohet në parlament!

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Pikërisht këtë po ju thoj!

Z. M. Çakaj: Këtu duhen bërë denoncimet që kanë të bëjnë me veprimtarinë e KQZ-së. Në rastin konkret, pyetja ime konkrete në mbledhjen e kaluar, nuk besoj nga ju. Pyetja ime konkrete në mbledhjen e kaluar ishte lidhur me përfaqësuesen e administratës së KQZ-së dhe koleges time, nëse së pari kishte denoncime apo jo dhe publikisht, besoj dhe ju e pranuat se cituat e deklaruat që ka denoncime dhe aty u mohua, së pari. Së dyti, që të jemi korrekt me fjalët pyetja ime konkret për drejtoreshën e votimit nga jashtë ishte nëse, KQZ ka autorizuar ndonjë parti politike për të kryer detyrën e saj dhe këtu nuk identifikova asnjë parti në veçanti. Identifikova raste konkrete dhe në këndvështrimin, gjykimin dhe vlerësimin tim, kjo është punë e dobët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve. Duhet të pranojmë dhe ne pavarësisht se është një organ tjetër, në mospërcjelljen e informacionit në mënyrën e duhur në mënyrë që një, dy, tre, katër, pesë subjekte politike të arrijnë të bëjnë këto gjëra, ta proklamojmë dhe publikisht, pra e bënë si zyrë pune 16:00-19:00, qoftë PS-ja qoftë PD-ja. Unë jam koherent në këtë qëndrim, është e papranueshme nga kushdo subjekt politik. Kaq.

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 17.01.2025*

Znj. E. Xhina, përfaqësuese e PS: Diskutimi im nuk ishte fare në vijim të diskutimit të herës së kaluar nga ana juaj. Ishte në vijim të diskutimit që bëri kolegu bashkëngjitur me mua. Nuk jam duke ju referuar fare rastit që u diskutua në mbledhjen e mëparshme dhe jam plotësisht dakord me çfarë ju deklaroni sot.

Znj. I. Nano: Faleminderit! Atëherë në vitin 2021 Komisioni Rregullator ka miratuar një vendim për mënyrat e funksionimit e të mirëmbajtjes së portalit, procedurat afatet e hetimit administrativ dhe pa dyshim duke u rregulluar kjo çdo denoncim mund të drejtohet sipas formateve të caktuara në këtë portal dhe sikundër unë mbaj të njëjtin qëndrim si në mbledhjen e kaluar që nuk jemi ne organi. Pa dyshim në këtë mbledhje, duke qenë se mbledhjet janë të hapura, me pjesëmarrje edhe të përfaqësuesve të partive politike të tyre mund të bëhen denoncime, por formalisht, por qoftë edhe nga ne, mund të bëhen denoncime si anëtarë të Komisionit Rregullator, pasi çdo qytetar e ka të drejtën për ta bërë. Por, le të orientohen të gjitha denoncimet nëpërmjet portalit në mënyrë që të jemi edhe ne, edhe partitë politike që venë në lëvizje administratën e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, por edhe Komisionerin, përveç asaj që zoti Çakaj e ka theksuar më herët, edhe në rastet kur vepron kryesisht, pra pavarësisht denoncimit. Zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Ne nuk jemi organ ekzekutiv, sa për kujtesë. Jemi një organ normues dhe në kujtesë të mbledhjes pararendëse pse lindi ky debat, ishte në kuadër të ndryshimeve që pësoi Vendimi nr. 9 i vitit 2020, i cili është një vendim thelbësor në ndjekje dhe sistemim, apo rregullim të problematikave që lidhen me abuzimin ndaj burimeve të gjitha llojeve publike. Në këtë kuadër u hap dhe ai debat dhe kolegu Çakaj proklamoi rastet dhe ndërkohë në këtë kuadër në meritë të ndryshimeve të tjera që prisnim në atë vendim, pyetëm nëse ka denoncime, na thanë që nuk ka

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 17.01.2025*

denoncime. Ndërkohë që po në protokollin e KQZ-së kishte mjaftueshëm denoncime të dorëzuara që herët nga subjekti Qëndresa Qytetare, i cili kishte dorëzuar një mori të madhe denoncimesh dhe ndërkohë nga KQZ-ja ende nuk ishte bërë jo vetëm ndryshime në përshtatje se çfarë po ndodh, por në të njëjtën kohë as kthyer ndonjë përgjigje as ne, në atë që ishte realisht, por as marr masa në raport me veprimtaritë e ndaluara të realizuara.

Znj. I. Nano: Faleminderit! Atëherë mesa shoh...Ka zoti Nuri diçka?

Z. F. Nuri, përfaqësues i PD: Po vetëm një sqarim në lidhje me çfarë deklaroj kolegia e Partisë Socialiste, për atë ç'ka unë thashë si përfaqësues i PD-së. Është e vërtetë që Partia Demokratike ka hapur portalin e saj që orienton dhe ndihmon zgjedhësit, edhe ajo që thatë ju, nuk e mohojmë si informacion. Ajo që unë dua të sqaroj është se e para, kjo vjen si shkak të vështirësisë së regjistrimit të zgjedhësve, sepse aktet që janë miratuar po rezultojnë që nuk janë kaq të thjeshta. Pra rregullat janë, kjo është një eufemizëm, për të mos thënë që është shumë e vështirë për t'u regjistruar. Duhet të kesh njohuri shumë të thelluara teknike në përdorimin e aparateve smartphone apo edhe teknologjisë që mund të arrish një regjistrim që me herën e parë. Por, në përgjigje të asaj që ju thatë, ne jemi parti në opozitë dhe nuk kemi asnjë burim shtetëror dhe asnjë burim publik. Për rrjedhojë nuk kemi si të abuzojmë me këto burime publike. Denoncimet tona kanë të bëjnë me ministrat që kanë rol të caktuar dhe me tagrin e ministrave dalin dhe kërkojnë takime në diasporë. Apo zyrtarë të tjerë të shtetit, apo rastet e zyrave vendore të arsimit e kështu me rradhë që i kanë denoncuar dhe shoqëria civile. Pra, ne këtu e kemi thelbin, te keqpërdorimi publike shtetërore dhe zyrtare që nuk janë të lejuara katër muaj para

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt. 17.01.2025*

zgjedhjeve. Partia Demokratike nuk ka asnjë burim të tillë në dispozicion në nivel qendror. Faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Nuri. Nuk kemi gjëra të tjera, besoj, për të shtuar dhe diskutuar. Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

*Zbardhi materialin audio
Areta DULAKU*

